



Flash Gjykata ka caktuar masën e sigurisë 'arrest në shtëpi' për Astrit Avdylin dhe 3 të tjerët

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Korrupsion për përfitim pronash, SPAK bastis zyrat e Kadastrës në Tiranë, 3 sekserë në pranga, 2 zyrtarë me detyrim paraqitje, pezullohet punonjësi i ASHK-it, 1 në kërkim

2



Lista e zezë/ Elvis Naçi i ndalohej hyrja në Amerikë?

3




'Jetonë i kamufluar, pa makinë e pa celular dhe përdorte transportin publik' medialet kolumbiene shkruajnë për 'Jimmy'n' bosi shqiptar të drogës

4



Raporti i OSBE kritikon Metën: Presidenti bëri fushatë kundër partisë në pushtet, gjuha e përdorur ishte konfrontuese

5



5 a 339, lironet nga qelia Nijja i Shkëmbit dhe 3 anëtarë të tjerë të grupit "Volvo 4", shkak kalimi i afateve të paraburgimit

Aktualitet

Detaje të reja nga arrestimi i biznesmenit në Shkodër! Jo vetëm arma, ja sa lekë iu gjetën me vete

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga arrestimi i biznesmenit Isuf Isufi, në Shkodër një ditë më parë.

SHKODËR- Detaje të reja kanë dalë në dritë nga arrestimi i biznesmenit Isuf Isufi, në Shkodër **një ditë më parë**.

Report Tv mëson se 49-vjeçarit përveç armës që iu gjet me vete, i janë gjetur edhe një sasi e konsiderueshme lekësh, që shkon mbi 2 mijë euro. Arrestimi i tij u në vendin e quajtur "Lagje Perash".



LEXO EDHE:

Tentoi të rrëmbejë me forcë të renë dhe goditi babanë e saj, arrestohet 29-vjeçari në Shkodër

Ndaj tij rëndon akuza për veprën penale "Armëmbajtja pa leje".



"Vijojnë kontrollet e befasishme për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri me vete. Qarkullonte me armë zjarri me vete në qytet, vihet në pranga 49-vjeçari. Sekuestrohet arma zjarrit dhe një shumë e konsiderueshme lekësh. Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe të komisariteve në varësi të saj vijojnë kontrollet e befasishme në kohë dhe vende të ndryshme, me qëllim kapjen e personave me precedent kriminal, personave në kërkim dhe të atyre që qarkullojnë me armë zjarri me vete.

Si rezultat i kontrolleve të befasishme, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative se një person qarkullonte në qytet me armë zjarri me vete, shërbimet e Policisë të Forcës së Posaçme "Shqiponja" në DVP Shkodër, në vendin e quajtur "Lagje Perash", kanë ndaluar shtetasin I. I., të cilit gjatë kontrollit i gjetën një armë zjarri pistoletë.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore të kryera nga specialistët e Hetimit të Krimit në Komisaratin e Policisë Shkodër u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit I. I., 49 vjeç, banues në lagjen Ajasëm, Shkodër, për veprën penale "Armëmbajtja pa leje". Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme", njofton Policia.

Isuf Isufi, njihet si biznesmen në Shkodër, ndërkohë që disa vite me pare ka qenë edhe zv/president i Villaznisë. Isuf Isufi është vëllai i shtetasit **Hasan Isufi**, i cili në prill të vitit 2020, plagosi një shtetas pas një konflikti për pronën.



Arma dhe paratë e sekuestruara



Isuf Isufi

B.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Shkoder Policia e Shkodrës arrestohet isuf isufi

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Konfirmohet rasti i parë Delta në Shqipëri, a duhet të ketë masa të shtuara?

Po

Jo

Nuk kam mendim

Komento

Komente

Taku:

20/07/2021 11:08

Ç'është ky mentalitet në 2021?! A është e ndaluar të mbash para me vete?! Nuk është ndonjë shumë e madhe për një biznesmen... pavarësisht se mban armë pa leje...

Përgjigju

Lajme të tjera


Aktualitet



Operacioni për pronat në Kadastrë, pamje gjatë shoqërimit të të arrestuarve në polici

26 Korrik, 22:11

Aktualitet



Masat kufizuese jepen me telefon nga Rama? Koraqi në Report Tv: Kemi muaj pa folur me kryeministrin! Në shtator rritje të rasteve me COVID, por s'do ketë mbyllje totale

26 Korrik, 22:02

Aktualitet



Operacioni 'Ndërmjetësi', policia jep detaje: 3 të arrestuar, 2 zyrtarë të Kadastrës detyrim paraqitje, 1 i pezulluar nga detyra dhe 1 në kërkim

26 Korrik, 21:09

Aktualitet



Një valixhe alarmon forcat RENEa dhe policinë e Tiranës, brenda saj gjenden rroba

26 Korrik, 20:47

Aktualitet



Aksioni në Kadastrë, zbardhen emrat e të arrestuarve, 1 i pezulluar nga detyra! Korrupsion për pronat në Tiranë

26 Korrik, 20:35

Aktualitet



Riaktivizohet sërish vatra e zjarrit në malin e Dukatit, dyshohet për zjarrvënien të qëllimshme

26 Korrik, 20:05